



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 30 shtator 2021
Nr. Ref.:RK1851/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI37/21

Parashtrues

Isa Tusha, Naser Tusha dhe Miradije Tusha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës Supreme
të Kosovës Rev. nr. 343/2019 të 24 dhjetorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Isa Tusha, Naser Tusha dhe Miradije Tusha (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), përfaqësuar nga Emrush Kastrati, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 343/2019 të 24 dhjetorit 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (1) [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe nenet 10 e 17 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).
4. Parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkuan që në pajtim me rregullin 42 të Rregullores së punës të mbahet seancë dëgjimore.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 22 shkurt 2021, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 26 shkurt 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Selvete Gërzhaliu-Krasniqi dhe Bajram Ljatifi.
8. Më 4 mars 2021, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesve të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe në pajtim me rregullin 32 të Rregullores së punës kërkoi nga ai që të dorëzon autorizimin për përfaqësim në Gjykatë dhe dëshminë (fletë-kthesën) që tregon datën kur parashtruesit e kërkesës kanë pranuar aktgjykimin e kontestuar.
9. Më 4 mars 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për regjistrim të kërkesës dhe po ashtu kërkoi nga Gjykata Themelore në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) që të dorëzon dëshminë (fletë-kthesën) që tregon datën kur parashtruesit e kërkesës kanë pranuar aktgjykimin e kontestuar.
10. Më 15 mars 2021, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës dhe Gjykata Themelore dorëzuan dokumentet e lartpërmendura.

11. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
12. Më 24 maj 2021, Gjykata kërkoi nga përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës që të dorëzojë dokumente shtesë, përkatësisht vendime të gjykatave të rregullta me qëllim të plotësimit të kërkesës.
13. Më 25 maj 2021, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës dorëzoi një dokument "urgjencë" me ç' rast kërkoi nga Gjykata që të vendosë sa më shpejtë për shkak të rrezikut të dëbimit të parashtruesve të kërkesës nga objektet-shtëpitë e tyre.
14. Më 31 maj 2021, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumentet shtesë, të cilat i kërkoi Gjykata.
15. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
16. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani, nxori Vendimin Nr. K.SH.KI37/21, duke e zëvendësuar Kryetaren paraprake Arta Rama-Hajrizi në rolin e saj si kryesuese në këtë Kolegj shqyrtues.
17. Më 21 korrik 2021, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen ta shtyjë për një seancë tjetër në përputhje me plotësimet e kërkuara.
18. Më 8 shtator 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

19. Nga shkresat lëndës rezulton se Kuvendi Komunal në Kaçanik më 30 shtator 1986 përmes vendimit nr. 01-465-21 konfirmoi interesin publik për rregullimin e ndërtesës P + 8. Për ndërtimin e ndërtesës dhe hapësirës së përbashkët, Kuvendi Komunal në Kaçanik filloi procedurat për shpronësimin e plotë të ngastrës kadastrale 1129 me një sipërfaqe të përgjithshme prej 992 m² në zonën kadastrale në Kaçanik që ishte në pronësi të paraardhësit ligjor (babait) të parashtruesve të kërkesës Sh.T. Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit (BVI), në pajtim me ligjin, paraqiti kërkesë për aplikimin e procedurës së kërkesës.
20. Më 21 janar 1987, organi kompetent me vendim nr. 465-26/86 e eksproprijoi plotësisht ngastrën kadastrale të sipërpërmendur nr. 1129/1 në sipërfaqe 992

m2 dhe pas ndarjes së fondeve në formën e një oferte për kompensim prej 2,300,000.00 dinarësh, urdhëron ndryshime të të dhënave në kadastrë dhe ngastra shndërrohet në tokë ndërtimore përkatësisht pronë shoqërore.

21. Paraardhësi ligjor (babai) i parashtruesve të kërkesës Sh.T., paraqiti ankesë kundër vendimit për eksproprijim mirëpo nuk ka asnjë provë që tregon se për shkak të mosmarrëveshjeve për çmim të eksproprijimit janë zhvilluar procedura gjyqësore.
22. Më 14 shkurt 1997, paraardhësi ligjor (babai) i parashtruesve të kërkesës, Sh.T., iu drejtua Komunës së Kaçanikut me kërkesë që të abrogohet Vendimi për eksproprijim e një pjese të ngastrës që shfrytëzohet si oborr i ndërtesës shoqërore, me arsyetim se nuk është duke iu nënshtruar destinimit për eksproprijim, në bazë të së cilës mund të konkludohet se me këtë kërkesë pronari i mëparshëm, paraardhësi ligjor (babai) i parashtruesve të kërkesës, Sh.T., e konfirmon shpronësimin në interesin publik dhe nuk kërkon kurrfarë çmimi por kërkon abrogimin e eksproprijimit.
23. Më 20 mars 2007, parashtruesit e kërkesës paraqitën padi duke kërkuar që për pjesën e ngastrës me sipërfaqe prej 367 m2, që ka qenë e paraparë për ndërtesën e përbashkët shoqërore P + 8, për çka parashtruesit e kërkesës pretenduan se asnjëherë nuk iu kishte marrë nga posedimi dhe se në mënyrë të papenguar e kanë pasur në posedim, dhe që atyre t’iu njihet pronësia dhe të ndryshohen të dhënat kadastrale me regjistrim të pronës në emër të tyre. Ndërsa për pjesën tjetër të ngastrës, në sipërfaqe prej 625 m2, ku ishte ngritur ndërtesa, parashtruesit e kërkesës kërkuar që t’iu paguhet kompensimi për eksproprijim në shumë prej 293.500,00 €, për shkak se bazuar në pretendimet e parashtruesve të kërkesës, atyre kurrë nuk ju është paguar kompensimi për sipërfaqen prej 625 m2.
24. Më 19 nëntor 2009, Gjykata Komunale në Kaçanik me Aktgjykimin C. nr. 92/19 kishte vendosur: **(i)** miratohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadija e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetohet se parashtruesit e kërkesës janë pronarë e një pjese kadastrale 1129/1 në sipërfaqe prej 0.03.67 ha, e cila evidentohet në fletën poseduese nr.937 Z.K. Kaçanik dhe përkufizohet, në anën veriore me rrugën sip.nr.1099, në lindje pk.nr.1130, në anën jugore me pk.nr.1129/2, pronë e parashtruesve të kërkesës dhe në anën perëndimore me rrugën-bulevardi Ismajl Raka; **(ii)** refuzohet kërkesëpadija e parashtruesve të kërkesës e pabazuar me të cilën kanë kërkuar që t’iu njihet e drejta e pronësisë në sipërfaqe prej 0.0.87 ha, e cila është pjesë e ngastrës kadastrale 1129/1 e evidentuar në fletë poseduese nr.937 ZK Kaçanik, po ashtu refuzohet kërkesëpadija mbi shumën e kërkuar prej shumës 176.000 euro deri në shumën prej 293.500 euro si të pabazuar; **(iii)** detyrohet e paditura Komuna e Kaçanikut, që parashtruesve të kërkesës t’iu paguaj shumën prej 176.000 euro në emër të kompensimit për tokën e eksproprijuar për sipërfaqen prej 0.05.87 ha, e cila është pjesë e ngastrës kadastrale 1129/1 e evidentuar në fletë poseduese nr. 937 ZK Kaçanik; **(iv)** detyrohet e paditura që parashtruesve të kërkesës t’ua njohë të drejtën e pronësisë për pjesën e shënuar në pikën I të këtij dispozitivi si dhe t’ua paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2.626 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

25. Në pjesën relevante të aktgjykimit të lartpërmendur, Gjykata Komunale kishte përcaktuar që: *"Pasuria kontestuese është eksproprijuar në vitin 1987, një pjesë e kësaj pasurie në sipërfaqe prej 0.03.67 ha, edhe pse është eksproprijuar, paditësit e kanë pasë dhe e kanë në posedim dhe shfrytëzim, në atë pjesë janë të vendosura garazha, shtalla, koteci dhe magacina për mbajtjen e materialit të teneqepunuesit, paditësit në këtë pjesë kanë fituar të drejtën e pronësisë me mbajtje me mirëbesim, ndërsa pjesën e pasurisë paditësit në sipërfaqe prej 0.05.87 ha, paditësit prej momentit të eksproprijimit nuk e kanë në posedim mirëpo ajo pjesë paditësve nuk ju është paguar, dhe në atë pjesë paditësve ju takon e drejta e kompensimit sepse ju është eksproprijuar dhe nuk ju është paguar dhe e paditura as nuk e ka filluar procedurën për kompensimin e dëmit e këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës me të cilat është vërtetuar se as në Gjykatën Komunale në Kaçanik dhe atë në Ferizaj nuk ka procedurë të iniciuar nga e paditura për kompensimin e dëmit, po ashtu e paditura me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se paditësve ju ka kompensuar pasurinë e eksproprijuar."*
26. Parashtruesit e kërkesës si paditës dhe Komuna e Kaçanikut si palë e paditur paraqitën ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë duke pretenduar se aktgjykimi i lartpërmendur karakterizohet nga shkeljet e procedurës kontestimore, konstatim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
27. Më 31 janar 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin Ac. nr. 1432/2009 vendosi që të refuzojë ankesat e parashtruesve të kërkesës dhe Komunës së Kaçanikut dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Kaçanik C. nr. 92/19 të 19 nëntorit 2009.
28. Parashtruesit e kërkesës paraqitën revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që pjesa e (ii) e dispozitivit që ka të bëjë me refuzimin e shumës së kërkuar prej 293.500 euro për sipërfaqen prej 0.05.87 ha, të kthehet në rigjykim apo aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që kërkesëpadia e paditësve në këtë pjesë të aprovohet në tërësi. Pala e paditur, Komuna e Kaçanikut po ashtu paraqiti revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.
29. Më 16 shtator 2013, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin Rev. nr. 62-12 vendosi: *"Pranohet revizioni i paditësve dhe revizioni i të paditurës dhe prishet Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut Prishtinë Ac.1432/2009 datë 31.1.2012 dhe ai i Gjykatës Komunale në Kaçanik C.nr.92/2009 datë 19.11.2009, ndërsa lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim."*
30. Pjesa relevante e Aktvendimit të Gjykatës Supreme përcakton: *"[...] Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore qëndron në faktin se dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është në kundërshtim me provat që"*

gjenden në shkresat e lëndës. Kjo ngase në shkresat e lëndës ekziston aktvendimi 04 nr.465-3 datë 13.4.1981 me të cilin është eksproprijuar parcela kadastrale nr.1129, fleta poseduese 148, në sipërfaqe prej 00.14.84 ha dhe procesverbali mbi marrëveshjen për caktimin e kompensimit të Drejtoratit për Ekonomi dhe Financa të Komunës së Kaçanikut 04 nr.465-3 datë 21.8.1981, me të cilin është vërtetuar se tani i ndjeri Sh.T., është pajtuar me shumën e ofruar nga ana e përfaqësuesit të eksproprijimit, ndërsa gjykata nuk ka siguruar proven-historiatin e parcelës së cekur për të vërtetuar se kur është bërë parcializimi i kësaj parcele në pjesët 1129/1 (cila është kontestuese dhe objekt shqyrtimi i kësaj çështjeje) dhe 1129/2 për të cilën palët janë deklaruar se është prone e paditësve [...] Gjykata e shkallës së parë në rigjykim është e detyruar t'i mënjanojë të metat e lartpërmendura, me provat e nevojshme t'i vërtetojë të gjitha faktet relevante për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje, të sigurojë historiatin e parcelës kontestuese, të kërkojë nga Arkivi i qytetit të Kaçanikut dhe Arkivi i Kosovës se a ekziston lënda e eksproprijimit të parcelës kontestuese sipas aktvendimit për eksproprijim, duke pasur parasysh se e paditura së bashku me paraqitjen e revizionit kundër aktgjyimit të shkallës së dytë, ka dorëzuar vërtetimin e datës 15.1.1987 të Shërbimit të Kontabilitetit Shoqëror-përfaqësia në Kaçanik, ndërsa këtë prove nuk e ka siguruar gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore, të angazhojë ekspertin financiar dhe atë të ndërtimtarisë për të dhënë mendim të përbashkët lidhur me çmimin real të tokës së eksproprijuar, e pastaj të merr një vendim të ligjshëm e të drejtë”.

31. Më 27 janar 2014, në procedurë të përsëritur, në bazë të aktvendimit të Gjykatës Supreme, Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik me Aktgjykim C. nr. 234/13 vendosi: **(i)** aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetohet se parashtruesit e kërkesës janë pronarë të një pjese të ngastrës kadastrale 1129/1, me kulturë jo pjellore në vendin e quajtur “Nerodime” në sipërfaqe prej 367 m², e cila evidentohet në fletën poseduese nr.937, Zona Kadastrale Kaçanik, e cila në anën veriore përkufizohet me rrugën si pk.nr.1099, në anën lindore me pk.nr.1129/2 pronë e parashtruesve të kërkesës dhe në anën perëndimore me rrugën Bulevardi Ismajl Raka Kaçanik; **(ii)** refuzohet e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së parashtruesve të kërkesës, me të cilën kanë kërkuar që t’iu njihet-pranohet e drejta e pronësisë në një pjesë ngastrës kadastrale 1129/1, në sipërfaqe prej 587 m², e evidentuar në fletën e posedimit ZK Kaçanik; **(iii)** detyrohet e paditura Komuna e Kaçanikut, që parashtruesve të kërkesës t’ua paguajë shumën prej 293.500 euro, në emër të kompensimit për tokën e eksproprijuar edhe atë për një pjesë të ngastrës kadastrale 1129/1, në sipërfaqe prej 587 m², e evidentuar në fletën poseduese nr. 937 ZK Kaçanik. Këtë shumë me kamatë si për mjetet e deponuara në bankë pa destinacion të caktuar të afatizuara mbi një vit, duke filluar nga data 11.11.2008, e deri me datën 20.12.2012 dhe prej datës 20.12.2012, e deri në pagesën definitive me kamatëvonesë në lartësi prej 8%, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi në dorëzim të aktgjyimit; **(iv)** detyrohet e paditura që paditësve t’ua paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 4.402 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi në dorëzim të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

32. Pjesa relevante e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, përcakton: *“Gjykata i analizoi theksimet e palës paditëse e cila kërkoi nga gjykata që kërkesëpadia të miratohet si e bazuar dhe të vërtetohet se paditësit janë pronarë të një pjese të ngastrës kadastrale 1129/1 në sipërfaqe prej 367 m2 dhe të detyrohet e paditura që t’ua kompensojë shumën prej 293.500 euro, këtyre theksimeve gjykata ua dha besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sepse për pikën I të dispozitivit të aktgjykimit paditësit e kanë fituar të drejtën e pronësisë me mbajtje, me mirëbesim ndërsa sa i përket kërkesës për pikën III të dispozitivit, e detyroi të paditurën që paditësve t’ua kompensojë shumën prej 293.500 euro, sepse e paditura këtë pasuri e ka eksproprijuar por të njëjtën nuk e ka kompensuar, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi [...] mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike e cila rezultoi nga të gjitha provat e vlerësuara, e të cilën nuk e kontestuan dhe nuk e vunë në dyshim me asnjë kundërprovë, Gjykata zbatoi dispozitat e nenit 28 të LMTHJP, neni 40 par.1 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, neni 46.3 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 1 të Konventës për të drejtat dhe liritë themelore dhe arriti deri tek përfundimi se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar dhe si e tillë u miratua në dispozitiv të këtij aktgjykimi”.*
33. Pala e paditur, Komuna e Kaçanikut paraqiti ankesë kundër aktgjykimit të lartpërmendur duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet e bazuar ndërsa kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës të refuzohet në tërësi e pabazuar.
34. Parashtruesit e kërkesës e kontestuan si të pabazuar ankesën e palës së paditur duke i propozuar Gjykatës së Apelit që ankesa të refuzohet ndërsa aktgjykimi i goditur të vërtetohet.
35. Më 15 mars 2017, Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ac. nr. 1134/14 vendosi: *“Aprovohet e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Kaçanikut, Prishtë aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega Kaçanik, C.nr.234/13 i datës 27.01.2014, dhe lënda i kthehet në rigjykim dhe rivendosje Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega Kaçanik.”* Gjykata e Apelit, mes tjerash, kishte përcaktuar: **(i)** Gjykata Themelore nuk ka përfillur në tërësi rekomandimin e Gjykatës Supreme për sigurimin e historiatit e parcelës kontestuese nr.1129/1 nga fleta poseduese nr. 937; **(ii)** pika II e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës themelore është jo e plotë e paqartë me të gjeturat e ekspertit gjeodet dhe e pa ekzekutueshme sepse nuk dihet saktësisht gjerësia dhe gjatësia e të gjitha anëve gjeografike të pjesës së ngastrës kadastrale nr. 1129/1; **(iii)** e njëjta vlen edhe për pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës themelore, sepse edhe për sipërfaqen prej 587 m2 të pjesës së ngastrës kadastrale nr. 1129/1 nuk i dihet gjerësia, gjatësia dhe përkufizimi i saktë nga të gjitha anët gjeografike; dhe, se **(iv)** nuk është vërtetuar saktësisht çështja faktike nëse paraardhësi i parashtruesve të kërkesës Sh.T., ka pranuar kompensim për eksproprijimin e ngastrës lëndore.
36. Më 20 dhjetor 2017, në procedurën e përsëritur në bazë të aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata Themelore me Aktgjykimin C. nr. 58/17 vendosi: **(i)**

aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës dhe vërtetohet se ata janë bashkëpronarë në 1/3 e pjesës ideale të ngastrës kadastrale 1129/3, me kulturë jo pjellore, në vendin e quajtur “Nerodime” në sipërfaqe prej 367 m² e evidentuar në certifikatën e njësishë kadastrale me numër 941-38507/2017 ZK Kaçanik; **(ii)** detyrohet Komuna e Kaçanikut, që parashtruesve të kërkesës t’ua paguaj shumën prej 293.500 €, në emër të kompensimit për tokën e eksproprijuar për një pjesë të ngastrës kadastrale 1129/1 në vendin e quajtur “Nerodime” në sipërfaqe prej 625 m², e evidentuar në certifikatën e njësishë kadastrale me numër 941-38508/2017 ZK Kaçanik; **(iii)** refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë së parashtruesve të kërkesës, me të cilën kanë kërkuar që t’u pranohet e drejta e pronësisë në pjesën tjetër të ngastrës kadastrale 1129/1, në sipërfaqe prej 625 m², e evidentuar në certifikatën e njësishë kadastrale me numër 941-38508/2017 ZK Kaçanik.

37. Gjykata Themelore kishte arsyetuar: **(i)** parashtruesve të kërkesës duhet t’u njihet e drejta e pronësisë në pjesën prej 367 m² sepse as ata dhe as paraardhësi i tyre asnjëherë nuk janë “deposeduar” nga paluajtshmëria e kontestuar; **(ii)** paluajtshmëria e kontestuar është shfrytëzuar pandërprerë që nga viti 1987 dhe mbi bazën e mirëbesimit kanë fituar të drejtën e pronësisë; dhe, se **(iii)** parashtruesit duhet të kompensohen financiarisht pasi që nuk ishte arritur qëllimi i eksproprijimit të pjesës prej 625 m² sepse shërben si parking i lirë për automjetet e qytetarëve.
38. Pala e paditur, Komuna e Kaçanikut paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar se aktgjykimi i goditur karakterizohet me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesën ta aprovoj të bazuar dhe që kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës të refuzohet në tërësi. Parashtruesit e kërkesës e kontestuan ankesën e të paditurës dhe propozuan që ankesa të refuzohet ndërsa aktgjykimi i goditur të vërtetohet.
39. Më 20 gusht 2019, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin Ac. nr. 593/18 e refuzoi të pathemeltë ankesën e të paditurës Komuna e Kaçanikut dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore C. nr. 58/17 të 20 dhjetorit 2017. Gjykata e Apelit vlerësoi: **(i)** dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës themelore është i qartë dhe i kuptueshëm dhe se arsyetimi ka rrjedhë logjike me dispozitivin; **(ii)** Gjykata Themelore ka vërtetuar drejtë dhe plotësisht faktet që ndërlidhen me gjendjen gjeodezike dhe kadastrale të paluajtshmërisë së kontestuar; **(iii)** bazuar në opinionet e ekspertëve ka detyruar të paditurën që parashtruesve të kërkesës t’ua kompensojë shumën prej 293.500 €.
40. E paditura, Komuna e Kaçanikut parashtroi revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen dhe kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës të refuzohet. Pjesën e kërkesëpadisë për kompensim-pala e paditur- e kontestoi duke e konsideruar të paafatshme. Parashtruesit e kërkesës paraqitën përgjigje në revizion duke kontestuar pretendimet e palës së paditur se kërkesa është parashkruar sipas nenit 379 të LMD-së.

41. Më 24 dhjetor 2020, Gjykata Supreme me Aktgjykimin Rev. nr. 43/2019 e pranoi si të bazuar revizionin e të paditurës Komuna e Kaçanikut dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 593/18 të 20 gushtit 2019 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore C. nr. 58/17 të 20 dhjetorit 2017.
42. Gjykata Supreme konstatoi: **(i)** gjykatat e instancës më të ulët kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale kur kanë përcaktuar se kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës është e bazuar; **(ii)** parashtruesit e kërkesës nuk janë në mirëbesim ngase gjatë tërë posedimit të pretenduar ata kanë qenë në dijeni se ngastra është ekspropriuar dhe është regjistruar në kadastër si pronë publike, me ç ‘rast nuk janë plotësuar kushtet ligjore për parashkrim fitues; **(iii)** sipas dispozitave të nenit 45 të LTHMPJ-së e drejta e pronësisë që e ka personi i caktuar mbi një send pushon kur personi tjetër fiton pronësinë mbi atë send, ndërsa në rastin konkret e paditura ka fituar pronësinë me vendime të autoriteteve publike; **(iv)** parashtruesit e kërkesës kanë kundërshtuar fitimin e pronësisë të palës së paditur me mjete ligjore por pa sukses; **(v)** gjykatat e rregullta gabimisht kanë zbatuar nenin 379 të LMD-së së vjetër në kombinimin me nenet 28 dhe 29 të LTHMPJ-së sepse parashtruesit e kërkesës me asnjë provë nuk kanë dëshmuar se brenda afatit 10 vjeçar kanë kërkuar kompensim; dhe, se **(vi)** paraardhësi i parashtruesve të kërkesës Sh.T., nuk ka kërkuar çmim apo kompensim për eksproprijim në interesin publik, por vetëm ka kërkuar abrogimin e eksproprijimit.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

43. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se me Aktgjykimin e kontestuar u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës] të KEDNJ-së dhe nenet 10 e 17 të DUDNJ-së.
44. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë: *“parashtruesit e kërkesës konsiderojnë se gjykata supreme e Kosovës me aplikimin e të drejtës materiale përkatësisht dispozitat ligjore nga neni 28 e 29 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (LTHMPJ) dhe neni 379 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore të vjetër (LMD) që këto dispozita ligjore kanë të bëjnë me parashkrimin fitues, posedimin me mirëbesim dhe parashkrimin e kërkesëpadisë, rezulton se këto dispozita materiale janë vlerësuar në dëm të parashtruesve të kërkesës, sepse derisa e paditura-Komuna e Kaçanikut i zhveshi apo ju muarr pronën parashtruesve të kërkesës në mënyrë arbitrare, pa ju kompensuar paluajtshmërinë e ekspropriuar si autoritet publik-shtetëror, tani rezulton se edhe Gjykata Supreme e Kosovës, në vend që të jetë e pa anshme dhe të gjykon mbi bazën e së vërtetës, tani edhe Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin Rev.nr.343/2019 të dt.24 dhjetor 2020 në mënyrë të pa bazuar apo në mënyrë arbitrare ju mohoj të drejtën parashtruesve të kërkesës për ta e gëzuar pasurinë e tyre, përkundër së drejtës së autoriteteve publike që prona private mundet që të eksproprijohet për interesin publik, por në pajtim me ligjin, ndërsa parashtruesit e kërkesës siç këtë e kanë gjetur-vërtetuar Gjykata Themelore ne Ferizaj-Dega në Kaçanik dhe Gjykata e Apelit të Kosovës”.*

45. *Më tej, parashtruesit e kërkesës pohojnë: “Parashtruesit e kërkesës asnjë herë nuk janë kompensuar për pronën e shpronësuar nga e paditura-Komuna e Kaçanikut, dhe tani një vendim të tillë të Komunës së Kaçanikut e fuqizon Gjykata Supreme e Kosovës, rezulton se kjo gjykatë i shkeli të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, pasi që iu dha përparësi dispozitave ligjore të cekura si më lartë në kundërshtim me Kushtetutën, Deklaratën Universale dhe Konventën [...] Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin e potencuar pa të drejtë dhe një anshëm e në dëm të parashtruesve të kërkesës e ka refuzuar kërkesë padinë e tyre kinse kemi vjetërsim të kërkesës, pasi që në rastin e parashtruesve të kërkesës nuk bëhej fjalë për vjetërsim të kërkesës në kuptim të përmbarimit apo detyrimit juridik, por rasti i parashtruesve të kërkesës ka pasur të bënë me kërkesat pronësore juridike, e për të cilën është vendosur me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, me aktgjykim të Gjykatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë Ac. nr. 593/2018 të dt.28 gusht 2019.”*
46. *Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata: (i) kërkesa të shpallet e pranueshme; (ii) në përputhje me rregullin 42 të Rregullores së punës të mbahet seancë dëgjimore; (iii) të konstatojë shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 1 të Protokollit nr.1 [Mbrojtja e pronës] të KEDNJ-së dhe nenet 10 e 17 të DUDNJ-së.*

Dispozitat ligjore përkatëse

Ligji mbi marrëdhëniet themelore juridike-pronësore, aprovuar nga Kuvendi i RSFJ, në seancën e Dhomës Federative datë 30 janar 1980.

Neni 28

Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fituese me kalimin e kohës prej tre vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim i sendit të luajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej dhjetë vjetësh.

Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh.

Trashëgimtari bëhet mbajtës me mirëbesim nga momenti i hapjes së trashëgimisë edhe në rastin kur trashëgimlënësi ka qenë mbajtës me këqbesim, e trashëgimtari këtë nuk e ka ditur as që ka mundur ta dinte kurse koha për parashkrimin fitues fillon të ece nga momenti i hapjes së trashëgimisë.

Neni 29

Mbi sendin në pronësin shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parashkrimin fitues.

Neni 45

E drejta e pronësisë që e ka-personi i caktuar mbi një send pushon, kur personi tjetër fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send.

Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve, aprovuar nga Kuvendi RSFJ, në seancën e Dhomës Federative më 30 mars 1978.

Neni 379

[Kërkesat e përcaktuara para gjykatës ose organeve të tjera kompetente]

Të gjitha kërkesat që janë përcaktuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim gjyqësor të formës së prerë ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me anë të pajtimit para gjykatës ose organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë vjet dhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër parashikimi.

Mirëpo, të gjitha kërkesat periodike që rezultojnë nga vendimet ose pajtimet e tilla dhe rrjedhin për pagesë në të ardhmën, parashkruhen në afatin e parashikuar për parashkrimin e kërkesave periodike.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

47. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
48. Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

49. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashikojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

50. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë specifikuar se kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 43/2019] të 24 dhjetorit 2020, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu kanë qartësuar të drejtat dhe liritë që ata pretendojnë se janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe kanë dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
51. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikon:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

52. Gjykata rikujton që rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së si dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme në bazë të dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin K104/21, parashtruese *Nexhmije Makolli*, aktvendim për

papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; shih gjithashtu rastin KI175/21, parashtuese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).

53. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*; dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuze dhe të paqarta”*. (Shih: më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si *“qartazi të pabazuar”*, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si *“qartazi të pabazuara”*, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 31 gushtit 2019; Pjesa III. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri më 284, shih gjithashtu rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 27, si dhe rastin KI175/21, cituar më lart, paragrafi 38).
54. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtuesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28).
55. Gjykata rikujton që parashtuesi i kërkesës në thelb pretendon dy lloje të shkeljeve, përkatësisht: i) shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 10 të DUDNJ-së, si dhe (ii) shkeljet e pretenduara të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1; si dhe nenit 17 të DUDNJ-së. Prandaj, Gjykata do t’i shqyrtojë këto pretendime individualisht.

i) Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe nenin 10 të DUDNJ-së

56. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtuesve të kërkesës konsiston në pretendimin e tyre se Gjykata Supreme ndryshe nga gjykatat e instancës më të ulët dhe në mënyrë arbitrare ka zbatuar të drejtën materiale përkatësisht dispozitat e neneve 28, 29 dhe 45 të LTHMPJ-së në kombinim me dispozitën e nenit 379 të LMD-së së vjetër çka ka rezultuar me shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe mbrojtje të pronës siç garantohet me Kushtetutë, KEDNJ dhe DUDNJ.

57. Në lidhje me këtë, Gjykata duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së, parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ. (Shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, parashtrues: *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, “Adem Jashari”, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 07 nëntorit 2019, paragrafi 40).
58. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. (Shih: në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 56; dhe KI62/19, cituar më lart, paragrafi 58).
59. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme në mënyrë logjike, të detajuar dhe mbështetje në bazë ligjore ka gjykuar çështjen e parashtruesve të kërkesës me ç ‘rast ka shpjeguar dhe interpretuar çështjen e eksproprijimit, kompensimit për eksproprijim dhe kushtet ligjore që duhet plotësuar për parashkrim fitues të pronës së kontestuar. Në rastin konkret, Gjykata Supreme ka refuzuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës ndaj pronës së kontestuar-çka në vetvete-nuk përbën cenim të procesit të rregullt gjyqësor apo shkelje të së drejtës në pronë. Sidomos, duke pasur parasysh se argumentet e parashtruesve të kërkesës janë dëgjuar dhe vlerësuar për çka Gjykata Supreme ka dhënë arsyetim mjaftueshëm të arsyetuar.
60. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson konstatimet e Gjykatës Supreme: (i) gjykatat e instancës më të ulët kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale kur kanë përcaktuar se kërkesëpadia e parashtruesve të kërkesës është e bazuar; (ii) parashtruesit e kërkesës nuk janë në mirëbesim ngase gjatë tërë posedimit të pretenduar ata kanë qenë në dijeni se ngastra është eksproprijuar dhe është regjistruar në kadastër si pronë publike, me ç ‘rast nuk janë plotësuar kushtet ligjore për parashkrim fitues; (iii) sipas dispozitave të nenit 45 të LTHMPJ-së e drejta e pronësisë që e ka personi i caktuar mbi një send pushon kur personi tjetër fiton pronësinë mbi atë send, ndërsa në rastin konkret e paditura ka fituar pronësinë me vendime të autoriteteve publike; (iv) parashtruesit e kërkesës kanë kundërshtuar fitimin e pronësisë të palës së paditur me mjete ligjore por pa sukses; (v) gjykatat e rregullta gabimisht kanë zbatuar gabimisht nenin 379 të LMD-së së vjetër në kombinimin me nenet 28 dhe 29 të LTHMPJ-së sepse parashtruesit e kërkesës me asnjë provë nuk kanë dëshmuar se brenda

afatit 10 vjeçar kanë kërkuar kompensim dhe, se (vi) paraardhësi i parashtruesve të kërkesës Sh.T., nuk ka kërkuar çmim apo kompensim për eksproprijim në interesin publik, por vetëm ka kërkuar abrogimin e eksproprijimit.

61. Lidhur me fitimin e pronës me mirëbesim dhe kompensim për eksproprijim, pjesa relevante e aktgjykimit të Gjykatës Supreme përcakton: *“[...] neni 28 paragrafi 2 i LTHMPJ-së për fitimin e pronësisë në patundshmëri parashihet plotësimi kumulativ i dy kushteve ligjore, që mbajtësi të jetë me mirëbesim dhe posedimi të jetë i ligjshëm, ndërsa sipas paragrafit 4 të këtij neni kërkohet që mbajtësi të jetë në mirëbesim, që në rastin konkret me vet faktin se pronari i mëparshëm kishte paraqitur kërkesë për abrogim të vendimit të eksproprijimit për këtë pjesë të ngastrës së eksproprijuar, rezulton se paditësit nuk janë me mirëbesim ngase vazhdimisht gjatë tërë kohës së posedimit të pretenduar ata kanë qenë në dijeni se ajo ngastër është e eksproprijuar dhe është regjistruar si pronë publike, kështu që nuk janë plotësuar kushtet e parapara ligjore për fitimin e pronësisë në patundshmërisë e kontestuar sipas ligjit të parashkrimit, për të cilën arsye, Gjykata supreme e vlerësoi si të bazuar pretendimin e të paditurës se nga ana e gjykatave të instancës më të ulët, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësve.”*
62. Lidhur me të drejtën për të kërkuar kompensim brenda afatit ligjor, pjesa relevante e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme përcakton: *“[...] Bazuar në faktin se me Aktvendimin nr. 465-26/86 me 21 janar 1987 me të cilin ngastra kadastrale 1129/1 është eksproprijuar në tërësi dhe është ofruar shuma e kompensimit prej 2.300.000 dinarë, ndërsa ndaj aktvendimit është ushtruar ankesë dhe është refuzuar ankesa, kurse me aktvendim përcaktohet se nëse palët nuk dakordohen për çmim atëherë duhet t'i drejtohen Gjykatës kompetente. Me asnjë provë paditësit nuk kanë mundur të dëshmojnë se brenda afatit të lartpërmendur 10 vjeçar kanë kërkuar kompensimin sipas marrëveshjes dhe se pagesa e këtij kompensimi është refuzuar, e po kështu brenda këtij afati nuk kanë kërkuar që eventualisht gjykata të vendos për lartësinë e këtij kompensimi.”*
63. Lidhur me veprimet e paraardhësit ligjor (babait) të parashtruesve të kërkesës Sh.T., pjesa relevante e aktgjykimit të Gjykatës Supreme përcakton: *“Duke u bazuar në kërkesën e datës 14 shkurt 1997, me të cilën pronari i mëparshëm i drejtohet Komunës së Kaçanikut me kërkesë që të abrogohet Vendimi mbi eksproprijimin e pjesës së ngastrës që shfrytëzohet si oborr i ndërtesës shoqërore, me arsyetim se nuk është duke iu nënshtruar destinimit për eksproprijim por me këtë kërkesë pronari i mëparshëm e konfirmon shpronësimin në interesin publik dhe nuk kërkon kurrfarë çmimi por kërkon abrogimin e eksproprijimit.”*
64. Gjykata vëren se në rastin konkret kemi të bëjmë me vlerësim dhe interpretim të ndryshëm të dispozitave ligjore për eksproprijim, kompensim për eksproprijim dhe parashkrim fitues të pronës së kontestuar me ç'rast Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit kanë gjykuar në dobi të parashtruesve të kërkesës kurse Gjykata Supreme ka refuzuar kërkesat pronësore të parashtruesve të kërkesës.

65. Gjkata rithekson se sa i përket gjyqësorit të rregullt, Gjkata Supreme është autoriteti më i lartë gjyqësor në Republikën e Kosovës (shih nenin 103.2 të Kushtetutës) dhe se interpretimi i saj i dispozitave ligjore përkatëse dhe çështjeve tjera të ligjit mbizotëron ndaj interpretimeve ligjore të Gjykatave Themelore dhe Gjykatës së Apelit. Në rastin konkret, vlerësimi dhe interpretimi i dispozitave ligjore nga Gjkata Supreme nuk ngre çështje të garancive procedurale dhe materiale nga nenet 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së dhe nenin 10 të DUDNJ-së (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI68/20, *Parashtrues Hysen Thaqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 marsit 2021, paragrafët 44-45).
66. Prandaj, Gjkata konstaton se parashtruesit e kërkesës përfituan nga procedura kontradiktore dhe se ata ishin në gjendje të paraqesin në faza të ndryshme të procedurës pretendimet dhe provat që ata i konsideruan të rëndësishme për rastin e tyre; ata kanë pasur mundësinë të hedhin poshtë në mënyrë efektive pretendimet dhe provat e paraqitura nga pala kundërshtarë; gjykatat e rregullta dëgjuan dhe shqyrtuan të gjitha pretendimet e tyre, të cilat, shikuar objektivisht, ishin të rëndësishme për zgjidhjen e rastit; arsyet faktike dhe ligjore për vendimin e kontestuar janë dhënë në hollësi dhe procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih: *mutatis mutandis*, aktgjykimi i GJEDNJ-së i 21 janarit 1999, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafët 29 dhe 30, shih gjithashtu rastin KI22/19, parashtrues *Sabit Ilazi*, aktvendim i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 si dhe rasti KI128/18, cituar më lart, paragrafi 58).
67. Në rrethanat e këtij rasti, Gjkata thekson se parashtruesi i kërkesës, përtej pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i vërtetimit të gabuar të fakteve dhe interpretimit të gabuar të ligjit, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës apo se procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Përveç kësaj, Gjkata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe kanë arsyetuar të njëjtat (Shih: në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI64/20, parashtruesi i kërkesës: *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41, dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).
68. Prandaj, Gjkata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm janë (i) pretendime që kualifikohen si pretendime të “shkallës së katërt” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenit 17 të DUDNJ-së

69. Sa i përket shkeljes së të drejtave të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit I të KEDNJ-së dhe nenin 17 të DUDNJ-së, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) e pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht;
- a) kur parashtuesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih: në këtë drejtim, rasti i GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005, shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtuesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43).
70. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtuesit e kërkesës kanë përmendur edhe shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit I të KEDNJ-së dhe nenin 17 të DUDNJ-së, por parashtuesit e kërkesës nuk japin arsyetim të detajuar se si ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve.
71. Sa i përket këtyre pretendimeve, Gjykata vëren se parashtuesit e kërkesës vetëm i përmendin nenet përkatëse, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi i neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së dhe përmendja e tyre nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtuesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, cituar më lart, paragrafi 81, KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52, KIO4/21 cituar më lart, paragrafët 38- 39).
72. Prandaj, Gjykata konstaton se përkitazi me pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkelje të të drejtave pronësore të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit I të KEDNJ-së dhe nenin 17 të DUDNJ-së, Gjykata konstaton se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i

takojnë kategorisë (iii) së pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara” sepse parashtruesit e kërkesës thjesht cituan një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar se si ato janë shkelur, dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesve të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

73. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. I të KEDNJ-së, si dhe me nenet 10 dhe 17 të DUDNJ-së, duhet të deklarohen të papranueshme në tërësi si qartazi të pabazuara, sepse këto pretendime të parashtruesve të kërkesës kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë (i) e pretendimeve që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt” dhe në kategorinë e (iii) pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara”. Rrjedhimisht, kërkesa, në tërësinë e saj duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të Rregullit 39 të Rregullores së punës.

Kërkesa e parashtruesve për shqyrtim verbal

74. Sa i përket kërkesës së parashtruesve për mbajtje të seancës dëgjimore, Gjykata i referohet nenit 20 [Vendimet] të Ligjit, që parashikon:

“1. Gjykata Kushtetuese vendosë mbi çështjen pas mbarimit të seancës së shqyrtimit verbal. Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga shqyrtimi verbal.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, sipas vlerësimit të saj, gjykata mund të vendosë mbi çështjen që është objekt shqyrtimi kushtetues mbi bazën e shkresave të lëndës.”

75. Gjykata konsideron se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur në këtë rast bazuar në dispozitën e nenit 20 paragrafit 2 të Ligjit (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI34/17, *Parashtruese Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 108-110).
76. Prandaj, kërkesa e parashtruesve të kërkesës për shqyrtim verbal refuzohet.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 8 shtator 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për shqyrtim verbal;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani